



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E  
TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2076/1 prot.

Tiranë më 25.09.2024

Lënda: Mbi bashkërendimin e një projektvendimi

**MINISTRISË SË BRENDSHME**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës suaj nr.5766/6 prot., datë 19.09.2024, administruar me tonën me nr. 2076 prot., datë 20.09.2024, përmes së cilës dërgohet për bashkërendim projektvendimi “Për përcaktimin e procedurës së krijimit të regjistrit elektronik, bazë të dhënash shtetërore, kriteret, mënyra dhe dokumentacioni për kërkesën për ID digjitale të rezidentit elektronik, përfshirë përpunimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave” së bashku me relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, konstatojmë përfshirjen e pjesshme të komenteve të Zyrës së Komisionerit, dërguar nëpërmjet shkresës nr.1348/1 prot., datë 29.05.2024, kjo edhe për faktin se sikurse citohet edhe në relacionin shoqërues, përmbajtja e tij është ristrukturuar e për rrjedhojë, projektvendimi në tërësi ka pësuar një sërë ndryshimesh dhe riformulimesh.

Kësisoj, në draftin e dërguar për bashkërendim, pas analizimit të përmbajtjes së neneve përkatëse, konstatojmë se në pikën 2, të nenit 5, (e cila lidhet dhe me sugjerimin tonë të mëparshëm) parashikohet shtesa e fjalisë si vijon: “...si dhe **me çdo regjistër tjetër shtetëror apo të dakordësuar, vetëm për të dhënat parësore të shtetasve të huaj që aplikojnë në këtë shërbim**”.

Në këtë rast, mendojmë që në projektvendim nuk duhet të lejohet aksesimi në mënyrë të përgjithshme pasi kjo, do të cënonte thelbin e së drejtës themelore për respektim e jetës private të individit. Vlerësojmë se duhet të respektohet parimi i mjaftueshmërisë së të dhënave dhe aksesimi të kufizohet vetëm në databaza specifike, duke marrë masat e duhura teknike dhe organizative të sigurisë së të dhënave.

Në këtë kuadër, propozojmë që termi “*me çdo regjistër tjetër shtetëror apo të dakordësuar*” i përdorur në këtë nen, të zëvendësohet me baza specifike/konkrete që do të aksesohen, duke kufizuar nivelet e aksesit në përmbushje të qëllimit të ligjshëm dhe pa e tejkaluar atë.

Gjithashtu, sugjerojmë që në Aneksin nr.1 “*Formulari standard i aplikimit për ID Digjitale në Republikën e Shqipërisë*” në fillim të tij ku citohet: “*Ky formular shërben...*” pas këtij paragrafi të shtohet edhe fjalia me përmbajtje: “*Të dhënat personale të grumbulluara nga plotësimi i këtij formulari do të përpunohen në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

Me përfshirjen e sa më sipër, projektvendimi vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**